

2 T sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

1. Informacion i përgjithshëm

"2 T" sh.p.k (Kompania) me NIPT K01731001M është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 29 Maj 2000 ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 03.03.2008 "Mbi Shoqerite tregtare".

Kapitali i nenshkruar i shoqërisë është 600,000,000 Lekë (gjashtëqind million Lekë) me ortak Z. Dritan Troksi dhe Z. Artan Sako.

Misioni i Shoqërisë në treg është kryerja e projekteve dhe ndërtimeve civile dhe industriale, ndërtimin e rrugëve, kanalizime,etj.

NIPT- i shoqërise është K01731001M.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në Rrugen: "Asim Vokshi", Nd.14, H 4, Ap 5, Tirane.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësimet dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësimet e supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit finansiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimesht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësimet dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë pëershkruar më poshtë:



2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimë bazohen në moshiën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshmë të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizonet

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR/Lekë	123.42	132.95
USD/ Lekë	107.82	111.10



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat finanțiară

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transakzionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument finanziar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e përasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transakzionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfugizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provzionit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të paqeshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua tē marra dhe tē dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njoftes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njoftur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njoftura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

John



3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)***Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivit.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finanziar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njoftes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët registrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë përbazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Amortizimi vjetor pasqyrohet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

Shoqëria llogarit amortizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale bazuar në jetën e dobishme të tyre sipas gjykimit të manaxhimit.

Në përputhje me SKK nr. 5 paragrafi 41 sipas të cilit "Përshtatshmëria e normave të amortizimit, metodave të amortizimit dhe përllogaritjes së vlerave të rekuperueshme duhet të rishihet rregullisht. Nëse konstatohet se jeta e dobishme aktuale e një aktivi afatgjatë material ndryshon dukshëm nga përllogaritia fillostarte, periudha e amortizimit duhet të ndryshohet. Gjithashtu nëse është e nevojshme, duhet të ndryshohen metodat e amortizimit dhe zvogëlimi i vlerës së mbetur të përllogaritur të një aktivi afatgjatë material. Efekti i ndryshimit të periudhës së amortizimit ose vlerës së rikuperimit do të kontabilizohet si ndryshim në vlerësimet kontabël, në përputhje me udhëzimet e SKK 1 (dmth në periudhën aktuale e ato të ardhshme, dhe jo në menyrë retrospektive).

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistroimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëherëshme dhe zbritjet e bëra përsasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përvèç diferenca të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga ķursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatushem të vitit, duke aplikuar normat tatumore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatumore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatumore në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatumore.

Shoqëria nuk ka burime diferenca të përkohshme që vijnë nga tatimi i shtyrë mbi fitimin.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiscale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksonin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizonet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizonet rimerren.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të paşqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nësë është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financier dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Vlera monetare në Lek</i>	19,432,144	69,203,214
Banka	18,216,004	63,757,654
Arka	1,216,140	5,445,560
<i>Vlera monetare në Valutë</i>	505,228,017	302,561,740
Banka	504,514,341	301,848,064
Arka	713,676	713,676
	524,660,161	371,764,954

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Klientë	1,320,471,950	1,119,668,196
	1,320,471,950	1,119,668,196

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të arkëtueshme nga Diteko	59,000,000	-
	59,000,000	-



2 T sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arketueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
TVSH për tu reimbursuar	194,296	169,493
TVSH parapaguar në doganë	5,757,503	-
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	-	33,496,959
Tatim fitmi	4,610,158	-
	10,561,957	33,666,452

8. Inventarë

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë :

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Materiale të para	825,586	1,321,460
	825,586	1,321,460

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Shpenzime të periudhave të ardhshme	901,211,777	964,673,013
	901,211,777	964,673,013

10. Parapagime përfurnizime

Parapagimet përfurnizime paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Parapagime përfurnizime	34,620,601	33,204,459
	34,620,601	33,204,459

11. Aktive financiare

Aktivet financiare paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Kuota në shoqërinë Diteko	10,000	10,000
Kuota në shoqërinë D6	30,000	30,000
Kuota në shoqërinë Navia shpk	21,000,000	19,000,000
	21,040,000	19,040,000



12. Aktive Afatgjata Materiale

	Toka, troje dhe terrene	Mjete transporti	Mobilje e pajisje zyre	Të tjera	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2017	177,063,535	41,451,675	7,660,954	226,176,164	
Shtesa	146,662,394	72,799,409 (811,380)	2,035,325 (811,380)	221,497,128	
Pakësime					
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	323,725,929	113,439,704	9,696,279	446,861,912
 Shtesa	 43,578,431	 62,101,938	 20,684,718 (799,999)	 1,306,326 (799,999)	 127,671,413
Pakësime					
Gjendja më 31 dhjetor 2018	43,578,431	385,827,867	133,324,423	11,002,605	573,733,326
 <i>Amortizimi i akumuluar</i>	 	 	 	 	
Gjendja më 1 janar 2017	61,393,798	13,457,312	2,401,603	77,252,713	
Amortizimi i vitiit	35,460,630	12,853,848	1,318,662	49,633,140	
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	96,854,428	26,311,160	3,720,265	126,885,853
 Amortizimi i vitiit	 18,261,848	 50,724,462 (479,282)	 1,330,592 (479,282)	 70,316,902 (479,282)	
Pakësime					
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	115,116,276	76,556,340	5,050,857	196,723,473
 <i>Vlera neto kontabëli</i>	 	 	 	 	
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	226,871,501	87,128,544	5,976,014	319,976,059
Gjendja më 31 dhjetor 2018	43,578,431	270,711,591	56,768,083	5,951,748	377,009,853



13. Llogari të tjera të arkëtueshme afatgjata

Llogaritë të tjera të arketueshme afatgjata më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Investime tek D6	218,000	218,000
Investime tek Diteko	18,004,787	16,604,787
Hua ndaj Eriol	469,081,110	302,000,000
Hua të dhëna të tjera	14,616,800	14,616,800
	501,920,697	333,439,587

14. Hua Afatshkurter

Huatë afatshkurter më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Overdraft Credins bank në Lekë	282,589,533	82,084,629
Overdraft Credins bank në USD	398,062,701	228,116,607
Overdrafte të tjera	9,335	19,907
	680,661,569	310,221,143

15. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të pagueshme ndaj furnitorëve	944,394,627	785,629,655
	944,394,627	785,629,655

16. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të pagueshme ndaj ortakëve	180,236,669	206,632,817
	180,236,669	206,632,817



17. Detyrime tatumore

Detyrimet tatumore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	3,088,859	3,396,453
Tatim mbi te ardhurat personale	336,686	321,380
Tatim mbi fitimin	-	38,607,956
TVSH për tu paguar	-	4,037,578
Tatim në burim	16,500	-
	3,442,045	46,363,367

18. Parapagime të arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Parapagimet e arkëtuara	417,222,120	538,080,019
	417,222,120	538,080,019

19. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Paga për tu paguar	18,223,337	8,878,448
Detyrime të tjera ndaj punonjësve	-	33,440,000
Kreditorë të tjerë	37,465,304	55,357,164
	55,688,641	97,675,612

20. Detyrime për qera financiare

Detyrimet për qera financiare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Qera financiare afatshkurtër	2,221,495	-
Qera financiare afatgjatë	10,036,181	-
	12,257,676	-



21. Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërise është 600,000,000 LEK i zotëruar 50% nga ortaku Artan Sako dhe 50% nga ortaku Dritan Troksi.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Numri i kuotave	2	2
Vlera nominale (në LEK)	300,000,000	300,000,000
Kapitali i nënshkruar	600,000,000	600,000,000

Rezerva ligjore e shoqërisë ka vlerën 40,366,890 Lekë më 31 dhjetor 2018. (2017: 23,451,679 Lekë)

Rezervat e tjera të shoqërisë kanë vlerën 571,784,677 Lekë më 31 dhjetor 2018. (2017: 250,395,674 Lekë)

Fitimi i ushtrimit të shoqërisë ka vlerën 245,267,668 Lekë më 31 dhjetor 2018. (2017: 338,304,214 Lekë)

22. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga ndërtime dhe mirembajtje rrugësh	2,279,623,590	2,243,359,771
	2,279,623,590	2,243,359,771

23. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Te ardhura/shpenzime nga kembimet valutore nga aktiviteti operativ	(12,414,786)	(8,534,611)
Të ardhura nga qeraja	1,638,552	1,728,948
Te ardhura te tjera	(8,315,079)	706,650
Të ardhura nga shitja e aseteve	29,283	-
	(19,062,030)	(6,099,013)

Rezultati nga shitja e aktiveve

Të ardhura nga shitja e aktiveve	350,000
VKN	(320,717)
	29,283



24. Lëndë të para, materiale dhe shërbime

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Lëndë të para materiale	983,303,154	937,336,817
Trajtime të përgjithshme	628,370,066	548,876,296
Mirëmbajtje dhe riparime	63,966,066	57,633,247
	1,675,639,286	1,543,846,360

25. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Blerje energji, gaz ujë	2,458,903	914,117
Reklama	584,652	491,404
Shërbime bankare	2,594,549	12,251,489
Shpenzime per sigurime	3,250,142	5,085,170
Shpenzime postare e telekomunikacioni	1,586,826	1,457,312
Shpenzime qiraje	13,860,733	3,000,000
Shpenzime transporti	4,081,212	6,565,795
Taksa e tarifa vendore	5,513,196	3,688,281
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	8,546,740	3,055,928
Të tjera	5,869,433	6,942,302
Transferime, udhëtim, dieta	2,783,340	71,010,566
	51,129,726	114,462,364

26. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime page	137,522,133	107,972,581
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	22,497,474	17,634,066
	160,019,607	125,606,647

27. Shpenzime amortizimi

Shpenzimet e amortizimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime amortizimi	70,316,902	49,633,140
	70,316,902	49,633,140



28. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Gjoba dhe dëmshpérblime	2,430,731	5,243,366
	2,430,731	5,243,366

29. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financier të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga interesat	(40,583,069)	(251,626)
Shpenzime për interesa	53,191,853	-
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	(562,626)	(209,751)
	12,046,158	(461,377)

30. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fitimi para tatimit	288,979,150	398,930,258
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	2,430,731	5,243,366
Gjoba dhe dëmshpérblime	2,430,731	5,243,366
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	291,409,881	404,173,624
Tatim fitimi @15%	43,711,482	60,626,044
	245,267,668	338,304,214

31. Transaksionet me palët e lidhura

Shpérblimin total të dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 është 3,000,000 Lekë (2017:3,000,000 Lekë).



32. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çeshtje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financier të Shoqërisë ose ndryshimë në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2018 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

33. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

